TRIBUNA SINDIKALE

Nëntor 2008

Dhe dritë e diturisë
përpara do na shpjerë





Editorial

KERKESAT E SINDIKATAVE PER PERMIRESIMIN E PENSIONEVE TE MESUESVE

Permiresimi i sistemit te pensioneve te mesuesve dhe rritja e vazhdueshme e tyre ka qene dhe mbetet nje kerkese e perhershme dhe e rendesishme e Sindikatave te Arsimit. Po si eshte realizuar deri me sot kjo kerkese? Kuadri ligjor ekzistues, ne baze te te cilit funkionon sistemi i pensioneve per mesuesit, perfshire ndryshimet qe jane bere ne legjislacion qe nga viti 1993 e ketej, tregon se te gjitha qeverite e periudhes se tranzicionit e deri me sot jane akoma larg kuptimit dhe vleresimit real te figures se mesuesit, te rolit qe ata luajne dhe te misionit qe kane si edukatore te pazevendesushem per arsimimin cilesor te brezave te rinj, si nje parakusht per gjithe progresin shoqeror ne vendin tone.

Ligji nr. 7703, date 11.05.1993, "Per sigurimet Shoqerore ne Republiken e Shqiperise", ne krahasim me Ligjin e mepareshem te vitit 1966, (Ligji nr. 4171 date 13.04.1966), e rriti me 5 vjet moshen e daljes ne pension, si per burrat ashtu edhe per grate e punesuara ne arsim ne profesionin e mesuesit. Megjithe moshen mesatare shume te re te popullsise ne vendin tone, rritja me 5 vjet e moshes per daljen ne pension per profesionin e mesuesise ishte e pranueshme.

Por, 10 vjet me vone, me Ligjin nr. 9377 date 21.04.2005, mosha e daljes ne pension per mesuesit u rrit, si per burrat ashtu edhe per grate, edhe me 5 vjet te tjera, duke arritur kufirin e 60 vjetve per grate dhe 65 vjetve per burrat. Kjo rritje e moshes se pensionit u kundershtua nga sindikalistet e te gjithe profesioneve dhe vecanrisht edhe nga mesuesit. Pretendimi se Ligji i sipercituar, me mundesine e daljes ne pension te pjeseshem pleqerie 3 vjet perpara moshes se percaktuar ne ligj, si per burrat ashtu edhe per grate, nuk e lehteson, por perkundrazi e rendon poziten e mesuesit qe kerkon pension te parakoheshem, sepse nje dispozite tjeter e po ketij ligji thote se ai qe kerkon dhe perfiton pension te pjeseshem pleqerie, me mbushjen e moshes per pension, nuk ka te drejte te marre pension te plote, por do te marre pergjithemone masen e pensionit te pjeseshem.

Sindikatat e Arsimit, FSASH dhe SPASH, kane kerkuar me kembengulje dhe do te fillojne se shpejti bisedimet me punedhenesin dhe segmentet perktese te Qeverise per te bere permiresime ne Ligjin per pensionet, ne favor te mesuesve qe dalin ne pension.

Cilat jane keto kerkesa dhe cfare synojne sindikatat qe te permiresohet ne kete ligj ?

Se pari, kerkesa e sindikatave eshte qe te shfuqizohet dispozita e sotme qe penalizon kerkuesit dhe perfituesit e pensionit te parakoheshem ose pensionit te reduktuar, duke i denuar ata qe pensionin e parakoheshem te reduktuar te mos kene mundesine ta kthejne ne pension te plote pleqerie, kur te mbushin moshen qe kerkon ligji.

Se dyti, koha e perfitimit te pensionit te pjeseshem, si per burrat ashtu edhe per grate ne profesionin e mesuesise, te jete 5 vjet, nga 3 vjet qe eshte sot, dmth grate te kene te drejte per per te perfituar me kerkesen e tyre pension te pjeseshem pleqerie mbi moshen 55 vjec dhe burrat duke filluar nga mosha 60 vjec. Masa e ketij pensioni te jete jo me pak se 60 perqind e pages mesatare mujore qe nxirret nga shuma e pergjithshme e pagave te marra gjate 3 vjeteve rresht brenda 10 viteve te fundit te punes dhe me mbushjen e moshes 60 vjet per grate dhe 65 per burrat, pensioni i pjeseshem te shnderrohet ne pension te plote pleqerie.

Se treti, grave mesuese qe, ne baze te nenit 97 te Ligjit nr. 7703 date 11.05.1993, kane perfituar pension te pjeseshem pleqerie, me mbushjen e moshes per pension te plote, t'u mundesohet perfitimi i pensionit jo mbi pagen e kohes kur kane dale ne pension te pjeseshem, sic veprohet deri tani, por llogaritja te behet njelloj sic veprohet per mesuesit qe dalin sot ne pension te plote pleqerie, bazuar mbi pagen e grupit, vjetersine, kualifikimin dhe pozicionin.

PERMBAJTJA

Editorial

- Kerkesat e sindikatave per permiresimin e pensioneve te mesuesve 2
- Te bejme realitet detyrimet e punedhenesit per motivimin e mesuesve te dalluar 3
- Seminar mbi bashkepunimin e mesuesve me nxenesit dhe prinderit per eliminimin e punes se femijeve 4
- Takim i rendesishem me drejtues e perfaqesues te DAR e ZA te Qarkut te Vlores 6
- Konsolidimi i Seksioneve sindikale kerkon pergjegjesi personale dhe kolegjialitet, (Nga mbledhja e KD te FSASH) 7
- Te forcojme strukturat sindikale te SPASH ne te gjitha nivelet (Nga mbledhja e KK te SPASH) 8
- U nda nga jeta Zv/Kryetari i FSASH, Berti Caprazi 10
- Prezantohet drafti perfundimtar i Kodit te Etikes se Mesuesit 10
- Nga drafti mbi Reformen e Sistemit te Zhvillimit Profesional te Mesuesve 12
- Vater e zjarrte per dituri e atdhetarizem, (Ne Gjimnazin "28 Nentori", Shkoder) 14
- Te reja shkencore dhe Keshilla praktike 15

Kopertina e pare:
Nga takimi i perfaqesuesve te FSASH/SPASH per prezantimin e Kodit te Etikes per mesuesit
Kopertina e fundit:
Nga Seminari mbi bashkepunimin mesues, nxenes, prinder per eliminimin e punes se femijeve

TRIBUNA SINDIKALE
Nr. 37
Nëntor 2008
Botim i FSASH dhe SPASH
Me mbeshtetjen financiare te Konfederates se Sindikatave te Holandes, FNV
ADRESA:
Rruga "Dora D'Istria", Pallati Perballe Fakultetit Juridik,Kati i 3-te, Tirane
Tel & Fax + 355 4 225 65 32
Celular: + 355 68 20 34 674,
+ 355 69 22 69 795, + 355 68 21 52 891
E-mail: fsash@abcom-al.com
Internet: www.fsash-spash.com
Keshilli Botues:
Xhafer Dobrushi,
Bajram Kruja,
Lumturi Mataj,
Delrim Spahiu,
Petref Celaj,
Aleks Dushi,
Stavri Liko, **Kryeredaktor**

TE BEJME REALITET DETYRIMET E PUNEDHENESIT PER MOTIVIMIN E MESUESVE TE DALLUAR

Nga Xhafer Dobrushi, kryetar i FSASH

Sot, kudo ne Europe e me gjere, perfshire edhe vendin tone, flitet shume per objektivat madhore ne fushen e arsimit, objektiva qe synojne nje **arsim cilesor publik, shanse te barabarta per te gjithe femijte e moshes se arsimimit te detyruar dhe te mesuarit gjate gjithe jetes.** Arritja e ketyre objektivave nuk eshte synim vetem i mesuesve e pedagogeve, i sindikatave te arsimit, nxenesve dhe prinderve. Nuk eshte dhe nuk mund te jete synim vetem i Ministrise Arsimit dhe Shkences. Keto objektiva duhet te perbejne synime paresore per cdo qeverisje, per forcat politike te vendit, per gjithe shoqerine. Kjo sepse arritja e tyre nuk ka te beje vetem me zhvillimin e nje sektori, sic eshte arsimi, por me gjithe shoqerine, kushtezon progresin dhe mireqenien e saj per te sotmen dhe te ardhmen. Mijevjecari i ri dhe shekulli i pare i tij karakterizohen nga zhvillime te larta te shkences, teknikes e teknologjise. Dhe popujt qe aspirojne te ecin perpara, te integrohen ne familje te medha, sic eshte ajo europiane apo euroatlantike, nuk kane rruge tjeter vecse arsimimin cilesor te brezave te rinj, qe arrihet nepermjet nje shkolle te reformuar dhe te konsoliduar.

Eshte e njohur se nje nga faktoret baze qe mundesojne suksesin ne procesin e reformimit dhe konsolidimit te shkolles ne te gjitha nivelet eshte **mesuesi.**

Sindikatat e Arsimit, te perfshira ne kete proces transformimi, po bejne perpjekje per nje vleresim me real dhe me te mire te figures se mesuesit, perfshire jo vetem respektin ndaj tij, por edhe nje trajtim material qe nenkupton page, shperblime dhe kushte pune e jetese me te mira ne pershtatje me cilesine e punes qe ben dhe kontributit qe jep per arsimimin e nxenesve.

Ne saj te luftes se vendosur qe kane zhvilluar sindikatat, por edhe nga predispozicioni qe ka treguar qeveria, sidomos ne keto 3 vitet e fundit, pagat e mesuesve te sistemit te arsimit parauniversitar kane ardhur duke u rritur nga viti ne vit. Sot mesatarja e pages neto te nje mesuesi ne arsimin parashkollor eshte 29.826 leke, ne arsimin 9 vjecar 31.875 leke dhe ne arsimin e mesem 34.160 leke. Keto paga i perfitojne te gjithe mesuesit, ose me sakte rreth 36.000 prej tyre, qe jane te punesuar ne menyre definitive ne nivelet e ndryshme te arsimit parauniversitar, pavaresisht rezultateve qe arrijne ne procesin mesimor.

Por, ne kete rast, nuk e kemi fjalen vetem per pagen qe merr sot nje mesues sipas grupit, dmth diplomes qe ai zoteron, sipas vjetersise dhe kualifikimit qe ka dhe sipas pozicionit qe ze ne piramiden e punonjesve te arsimit parauniversitar, sepse ky nivel page eshte i garantuar per te gjithe. **Fjala eshte per te dalluar ata mesues qe jane shembull i mbajtjes dhe i mbrojtjes se figures se tyre si edukator, qe jane te angazhuar dhe ne pararoje te punes per arritjen e objektivave per nje arsim publik cilesor, qe ofrojne per nxenesit nje mesim-dhenie te nivelit bashkekohor, qe sakrifikojne nga vetja e tyre per t'u qendruar afer nxenesve qe kane nevoje, perfshire ata me probleme, qe ndikojne ne uljen dhe minimizimin e numrit te nxenesve qe braktisin shkollen ose frekuentojne me nderprerje, sepse punojne ne rruge,** etj.

Jane keta mesues qe duhen vleresuar e respektuar per punen qe bejne. Jane keta mesues **qe duhen motivuar**, duke i shperblyer, duke i paguar per ate cka japin me shume se koleget e tyre. Ketu nuk eshte fjala per sakrifica te medha nga buxheti i shtetit, por per perdorimin drejt, me kriter, te atyre fondeve qe permban buxheti ekzistues.

Nje burim i rendesishem brenda buxhetit te cdo viti eshte **Fondi i Veçante.** Me ligj ky Fond eshte i barabarte me 5 perqind te fondit te pergjithshem te pagave bruto te mesuesve te sistemit parauniversitar. Pra, behet fjale per me shume se 1 miliarde leke te reja. Ne baze te vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 434 date 28.06.2006 dhe te Udhezimit te Ministrit te Financave Nr.21 date 18.09.2007, ky fond perballon shperblimin prej 10.000 lekesh qe mesuesit marrin ne fund te vitit, perballon veprimatri te programuara kulturore, ndihmat ne raste fatekeqesish, dhenien e deri dy pagave per mesuesit anetare te sindikatave qe dalin ne pension dhe **per te shperblyer mesuesit e dalluar per pune cilesore.** Pikerisht per kete flet Kontrata Kolektive e Punes e nivelit te pare, nenshkruar me 4 Korrik 2006 nga Ministri i Arsimit dhe Shkences, nga njera ane dhe kryetaret e FSASH e SPASH, nga ana tjeter. Ne nenin 8, pika 8, shkronja "b" te kesaj Kontrate shprehimisht thuhet: "Ne fund te cdo viti mesimor DAR dhe ZA ne bashkepunim me Seksionet Sindikale perkatese, duke u mbeshtetur ne kontrollet e kryera dhe ne vleresimet qe bejne drejtoret e shkollave dhe keshillat sindikale perkatese shpallin per cdo shkolle e rreth mesuesit me te mire te vitit". Zbatimi i kesaj kerkese te Kontrates Kolektive te Punes nga punedhenesit dhe punemarresit e nivelit te dyte perben bazen per te motivuar mesuesit e dalluar gjate vitit kalendarik ose ne fund te tij deri ne

Vijon në faqen 4

Vijon nga faqja 1

masen e nje page mujore.

Por, megjithe kerkesat e Seksioneve Sindikale, kjo dispozite e KK te Punes nuk po gjen zbatim nga DAR dhe ZA. Praktika qe u zbatua ne fund te vitit te kaluar nga keto institucione ishte, ne pergjithesi, ndarje e barabarte e ketij fondi per te gjithe mesuesit e shkolles pavaresisht nga kontributi i tyre, ose organizimi i nje dreke apo darke festive. Sindikatat e kane denoncuar dhe e denoncojne kete praktike si abuzive, antiligjore, ne kundershtim me frymen e Ligjit per buxhetin e shtetit, ne kundershtim me dispozitat e VKM " Per Fondin e Vecante"dhe me KK te Punes. Perdorimi i ketyre fondeve ne kete menyre nuk i sherben qellimit per te cilin ato para jane akorduar, pra ky eshte nje shperdorim.

Ajo qe kerkojne sot FSASH dhe SPASH eshte qe Fondi i Vecante te mos shperdorohet. Ky Fond, mbasi te perballoje shperblimin prej 10.000 lekesh per cdo mesues ne fund te vitit, mbasi te zbriten prej tij shpenzimet qe jane bere per te shperblyer mesuesit qe dalin ne pension ose ndihmat ne rastet e fatkeqesive apo veprimtarite e spikatura kulturore, pjesa qe mbetet, dhe kjo eshte e konsiderueshme, te perdoret vetem per motivimin e mesuesve me te dalluar sipas kritereve qe percakton Kontrata Kolektive e Punes, kritere qe jane miratuar si nga Ministria e Arsimit dhe Shkences ashtu edhe nga Sindikatat.

Nese deri tani drejtorite e shkollave nuk kane indikatore te sakte mbi bazen e te cileve vleresohet puna cilesore e cdo mesuesi, ky nuk eshte faji i sindikatave. Sindikatat kane te dhena te sakta per ata mesues sindikaliste qe jane dalluar ne procesin mesimor, qe jane kualifikuar vete dhe kontribuojne ne kualifikimin e kolegeve te tyre per implimentimin e programeve te reja mesimore, qe jane dalluar ne punen me nxenesit qe frekuentojne me nderprerje mesimin dhe punojne ne rruge, ose qe kane sakrifikuar dhe sakrifikojne duke punuar me komunitetin, qeverine e nxenesve apo aktore te tjere te interesuar per te kthyer ne shkolle nxenesit braktises. Jane keta mesues qe, me punen dhe aftesite e tyre, me angazhimin serioz e te pergjegjshem per zbatimin e kerkesave te reformes e te Strategjise se Arsimit Parauniversitar, kane bere te mundur qe qindra nxenes ne rrethet Tirane, Shkoder, Durres, Fier, Korce, Elbasan etj, te dalin nga rreziku i braktisjes se shkolles dhe qindra te tjere qe e kishin braktisur me pare shkollen te kthehen e te vazhdojne mesimet si gjithe shoket e shoqet e tyre. Pikerisht keta jane shembulli me i mire nxites edhe per koleget e tjere te tyre, per te ngritur ne masen e madhe te mesuesve nje opinion te qendrueshem dhe te fuqishem kunder braktisjes se shkolles, punes se femijeve, shtimit te radheve te analfabetve ne shoqeri, etj.

Per kete ata meritojne qe te shperblehen.

Nga aktivitetet ne zbatim te Projektit me FNV/AOb

Seminar mbi bashkepunimin e mesuesve me nxenesit dhe prinderit per eliminimin e punes se femijeve

Nje seminar i rendesishem u organizua ne Durres, me pjesemarrjen e 30 mesuesve, nxenesve e prinderve, kryesisht nga shkollat pilot te rretheve Durres e Fier, ne vijim te aktiviteteve per zbatimin e Projektit me sindikatat holandeze FNV/AOb. Perfaqesues nga drejtorite arsimore te ketyre rretheve dhe nga drejtorite e shkollave pilot, si edhe kryetaret e dy sindikatave te arsimit, Xhafer Dobrushi e Bajram Kruja, moren pjese, gjithashtu, ne seminar.

Tre ishin prezantimet kryesore gjate ketij seminari:

- Kryetari i FSASH-it, Z. Xhafer Dobrushi, beri nje prezantim konkret mbi bashkepunimin midis mesuesve, nxenesve e prinderve, si nje parakusht per rezultate konkrete ne punen e perbashket, me synim uljen e numrit te nxenesve qe braktisin shkollen dhe eliminimin e punes se femijeve.

- Kryetari i Konfederates se Prinderve te Shqiperise, Z. Zenel Sina, beri nje prezantim interesant mbi rolin e prinderve dhe bashkepunimin e tyre me mesuesit e nxenesit dhe organet e tyre respektive ne shkolla.

- Perfaqesuesi i Drejtorise Arsimore Rajonale te Fierit, Z. Mihal Krimce, foli mbi rolin e vecante te administratave te shkollave dhe drejtorive arsimore ne kete sistem bashkepunimi.

Situata aktuale ne shkollat perkatese te dy retheve, por edhe me gjere, roli i sindikatave, mesuesve, nxenesve e prinderve ne keto shkolla e rrethe ne lidhje me shmangien e braktisjes se shkolles, ishin ceshtjet kryesore qe u bene objekt dikutimi ne kete seminar.

Diskutimet u bazuan tek rezultatet konkrete e reale qe dolen nga pyetesoret e plotesuar kohe me pare nga mesuesit pjesemarres ne seminar, te cilet nderkohe kane bere nje pune individuale me nxenesit e identifikuar. Mesuesit, nxenesit dhe prinderit folen per punen e vete e te kolegeve te tyre ne teresi, por ne te njejten kohe, ata sollen raste konkrete

qe kane rezultuar me kthimin e nxenesve ne shkolle, ose daljen e tyre nga rreziku i braktisjes se shkolles.

Keshtu, Ariana Plaku nga shkolla e Roskovecit, solli ne seminar pervojen e mesuesve te kesaj shkolle per kthimin ne shkolle te 5 nxenesve qe e kishin braktisur ate, nderkohe qe puna eshte duke vazhduar edhe me 5 nxenes te tjere, kryesisht nga klasat e nenta, te cilet e konsiderojne veten te rritur tashme dhe rrezikojne ta braktisin shkollen.

Po keshtu mesuesi Festim Meta, nga shkolla e Zhupanit, informoi me hollesi mbi punen qe kane bere mesuesit dhe nxenesit e kesaj shkolle, ne bashkepunim me prinderit, duke u perqendruar sidomos tek ata nxenes qe nuk ishin rregjistruar per kete vit shkollor, si edhe ata qe ishin rregjistruar formalisht, por nuk vinin ne shkolle, duke i kthyer ata ne shkolle.



Pothuajse te njejtat metoda te punes konkrete me nxenes te vecante raportuan edhe mesuesit Arqile Bitri nga shkolla e Levanit, mesuesja Marjeta Tafa nga shkolla Mbrostar Ura, mesuesja Majlinda Spahiu nga shkolla "Qemal Mici" ne Durres, mesuesi Fuat Zerdelia nga shkolla "Demokracia", mesuesi Nevruz Cismja nga shkolla "Bajram Curri 2", ku me shume se 30 mesues te ketyre shkollave jane duke punuar individualisht me me shume se 65 nxenes, duke bere te mundur kthimin ne shkolle te me shume se 32 prej tyre.

Ishte nje pervoje shume e mire organizimi i ketij seminari me pjesemarrjen e perbashket te perfaqesuesve te shkollave te Fierit, ku tashme ekziston nje pervoje shume e mire qe prej me shume se 4-5 vjetesh ne punen individuale me nxenesit qe kane braktisur shkollen ose qe jane ne rrezik per ta braktisur ate, si dhe te atyre te 5 shkollave te rrethit te Durresit, ku ka kohe tashme qe ka filluar nje pune e mire dhe e organizuar ne kete drejtim. Njohja e pervojes se deritanishme dhe shkembimi i mendimeve per pasurimin e metejshme te saj, ishte nje vlere shume e rendesishme e ketij seminari, gje qe do te kete nje ndikim te drejtperdrejte ne punen e te gjithe pjesemarresve gjate ketij viti shkollor e ne vazhdim.

Pjesemarrja ne seminar e drejtuesve te shkollave dhe perfaqesuesve te drejtorive arsimore ishte, gjithashtu, me shume vlera per te siguruar nje bashkepunim efektiv ne organizimin e kesaj pune ne te ardhmen. Duke folur ne seminar drejtuesit e te dy sindikatave, FSASH e SPASH, Xhafer Dobrushi e Bajram Kruja, e vune theksin, jo vetem te puna e mesuesve, por sidomos tek aktivizimi me i mire i vete nxenesve dhe perfshirja e sa me shume prinderve dhe perfaqesuesve te tjere te komunitetit, si parakusht shume i rendesishem per te patur rezultate konkrete ne kete pune.

Si rrjedhoje, pas diskutimeve konstruktive ne kete seminar disa nga konkluzionet kryesore ishin:

- Riorganizimi i grupeve te nxenesve e prinderve dhe organeve te tyre perfaqesuese ne shkolle, si Qeveria e Nxenesve dhe Komiteti i Prinderve, vecanerisht ne shkollat pilot te ketyre rretheve, por edhe me gjere, me synim rritjen e numrit te mesueve e nxenesve te angazhuar ne kete pune,
- Forcimi i bashkepunimit me drejtuesit dhe administratat e shkollave, sidomos ne drejtim te rritjes se rolit te mesuesve kujdestare dhe angazhimit te sa me shume mesuesve ne punen konkrete monitoruese me nxenssit e klasave ku japin mesim e me gjere,
- Zgjerimi i kontakteve te mesuesve me prinderit dhe forcimi i bashkepunimit me perfaqesuesit e pushtetit vendor, me qellim identifikimin e problemeve sociale ekonomike dhe marrjen e mesave te mundeshme per t'i ndihmuar ata qe te gjithe t'i dergojne femijet ne shkolle.

Pjesemarresit ne seminar nga te dy rrethet e konsideruan seminarin shume te vlefshem per punen e tyre dhe vleresuan menyren e organizimit te tij, me pjesemmarjen e shume aktoreve nga dy rrethe te ndryshme, duke premtuar se do te shumefishojne perpjekjet per te realizuar objektivat e percaktuara per kete vit shkollor e ne vijim.

Vijon në faqen 6

Takim i rendesishem me drejtues e perfaqesues te DAR e ZA te Qarkut te Vlores

Takimi me drejtues e perfaqesues te DAR e ZA dhe te seksioneve sindikale nga rrethet Vlore, Sarande e Delvine, organizuar ne Vlore, ne frymen e takimit qe u organizua pak kohe me pare ne Tirane me drejtues e perfaqesues te Ministrise se Arsimit e te Drejtorive Arsimore Rajonale dhe drejtues te seksioneve sindikale te FSASH e SPASH te qarqeve ne shkalle vendi, shenon nje moment te rendesishem per kordinimin e veprimeve dhe bashkepunimin e seksioneve sindikale te ketyre rretheve me drejtorite arsimore perkatese, si edhe te keshillave sindikale me administratat e shkollave ne keto rrethe.

Kryetari i FSASH, zoti Xhafer Dobrushi, paraqiti, ne mer te te dy sindikatave, mendimet e propozimet ne lidhje me zgjerimin e partneritetit midis te dy institucioneve, DAR e ZA, te ketyre rretheve nga njera ane dhe seksioneve perkatese sindikale te arsimit, nga ana tjeter. Ai vleresoi permiresimin dhe institucionalizimin e ketyre mardhenieve nepermjet Kontrates Kolektive te Punes te nivelit te pare e te dyte dhe vuri ne dukje perpjekjet qe po bejne te dyja sindikatat, jo vetem per mbrojtjen e interesave social - ekonomike te anetareve, por edhe per te kontribuar drejtperdrejt ne zhvillimin e reformes ne arsim, kualifikimin e mesuesve, angazhimin e sindikatave dhe te nje numri te konsiderueshem mesuesish per uljen e numrit te nxenesve qe braktisin shkollen dhe eliminimin e punes se femijeve.

Ne vijim ai e vuri theksin tek pergjegjesia dhe detyrimet e dyaneshme per institucionalizimin e ketyre mardhenieve, duke kerkuar jo vetem nga DAR e ZA, por edhe nga drejtuesit e seksioneve, qe te jene korrekte, aktive dhe konkrete ne mardheniet me drejtuesit e perfaqesuesit e DAR e ZA, gjithashtu, duke punuar, jo ne menyre individuale, por kolegjile, me perfshirjen edhe te perfaqesuesve te tjere te seksioneve perkatese.

Edhe Kryetari i SPASH-it, Z. Bajram Kruja, dhe perfaqesuesit e tjere te sindikatave te ketyre rretheve vleresuan angazhimin e Drejtorive Arsimore dhe administratave te shkollave per aktivitetet qe kane ndermarre sindikatat e arsimit, gje qe pritet te vije duke u zgjeruar e permiresuar edhe nepermjet Kodit te Etikes, qe eshte ne procesin perfundimtar te hartimit dhe miratimit.

Drejtori i Drejtorise Arsimore Rajonale Vlore, Z. Petro Kutulla, dhe perfaqesuesit e tjere te ZA-ve Sarande e Delvine, Aleko Gjoni e Shuaip Mehmeti, vleresuan punen e sindikatave ne rrethet perkatese, por nderkohe kerkuan nje kordinim me te mire midis paleve, sidomos persa u perket problemeve qe lidhen me organizimin e aktiviteteve te perbashketa dhe rritjen e rolit e te pergjegjesise se drejtuesve te seksioneve sindikale ne rrethe dhe te drejtuesve sindikale ne shkolla, jo vetem per mbrojtjen social ekonomike te mesuesve, por edhe per problemet e cilesise se mesimdhenies, zbatimit te disiplines e te etikes ne shkolle etj.

Drejtuesit e seksioneve te FSASH e SPASH te rrethit te Vlores, Petref Celaj e Mynyr Murati, dhe perfaqesuesit e tjere te sindikatave kerkuan forcimin e metejshem te bashkepunimit midis te dy paleve, sidomos duke perdorur me mire mesuesit e trajnuar nga sindikatat, materialet qe ato kane botuar si edhe motivimin me te mire te mesuesve qe jane te angazhuar mbi kohen normale te punes dhe kane rezultate te mira ne punen individuale me nxenesit qe kane braktisur ose jane ne rrezik per ta braktisur shkollen, duke perdorur me mire dhe me me efikasitet edhe buxhetin e Fondit te Vecante.

Ata kerkuan qe Ministria e Arsimit te zgjidhe problemin e pageses qe bejne edo vit mesuesit per viziten e detyruar mjekesore per Librezen Shendetesore, per shkak te profesionit, pagesen e deri dy pagave per mesuesit qe dalin ne pension, sipas Kontrates Kolektive te Punes, si edhe zgjidhjen korrekte te problemit te mesuesve qe jane me shkolle pedagogjike, ndaj te cileve ka patur edhe qendrime arbitrare etj.

Objekt i vecante diskutimi ishin ne Takim ceshtjet qe lidhen me zbatimin e detyrimeve ligjore qe kane Drejtorite dhe Zyrat Arsimore per kryerjen e veprimeve financiare, ne lidhje me zbritjen e kuotes se anetaresise se mesuesve anetare te FSASH e SPASH, nga liste pagesat e pagave. Drejtuesit e sindikatave sqaruan kuadrin ligjor te ketij veprimi financiar, bazuar ne Kodin e Punes dhe Kontraten Kolektive te Punes, ku perfshihen listat e rregullta te anetaresise te firmosura nga secili prej anetareve, ne te cilat theksohet se autorizohet mbajtja e kuotes se anetaresise, duke e zbritur ate nga borderoja perkatese.

Ne Takim u theksua domosdoshmeria e pergjegjesise se seciles prej paleve per zbatimin e detyrimeve qe kane ndaj njera-tjetres, jo vetem per kete ceshtje, por edhe per probleme te tjera qe lidhen me zbatimin e Kontrates Kolektive te Punes, te nivelit te pare e te dyte, kryerjen e reformes dhe zhvillimin cilesor te sistemit arsimor ne vendin tone etj.

Diskutimet e te gjithe pjesemarresve ishin konstruktive dhe perfaqesuesit e seciles prej paleve moren pergjegjesite e veta per forcimin e metejshem te partneritet real midis tyre, ne funksion te mbrojtjes se interesave te mesuesve dhe zhvillimit cilesor te arsimit ne vendin tone.

Pjesemarresit ne takim u pajisen me materialet didaktike e materiale te tjera, te botuara nga FSASH e SPASH, perfshire edhe Modulet SCREAM, Manualin mbi Arsimin Jo-Formal, botimet e fundit te Revistes «Tribuna Sindikale » etj.

Stavri LIKO

Nga aktivitetet e FSASH dhe SPASH

Konsolidimi i Seksioneve sindikale kerkon pergjegjesi personale dhe kolegjialitet

Nga mbledhja e KD te FSASH

Ne Durres u zhvillua mbledhja e Keshillit Drejtues te FSASH-it, me pjesemarrjen e anetareve te Keshillit, drejtues e perfaqesues te tjere te seksioneve sindikale te rretheve, e cila analizoi punen e bere, arritjet, mangesit e problemet gjate 10 mujorit te ketij viti dhe percaktoi drejtimet kryesore te punes per periudhen ne vijim.



Ne fjalen hyrese, Kryetari i Federates, z. Xhafer Dobrushi, u ndale tek masat qe jane marre e po merren per konsolidimin e seksioneve sindikale dhe riorganizimin e disave prej tyre ku jane verejtur dobesi e te meta, duke nenvizuar edhe kontributin dhe ndihmen e sindikatave holandeze FNV/AOb, nepermjet aktiviteteve te Projektit qe eshte duke u zbatuar nga te dyja sindikatat tona te arsimit.

Ai vuri ne dukje punen e mire qe eshte bere kohet e fundit ne rrethet e Gramshit, Beratit, Mirdites, Tiranes Rreth dhe Elbasanit, ku jane riorganizuar seksionet sindikale dhe jane zgjedhur ose komanduar drejtues te afte e te perkushtuar per te punar se bashku me nje aktiv te gjere te FSASH-it, me synim zgjerimin e anetaresise, njohjen e problemeve dhe angazhimin per zgjidhjen e tyre, ne bashkepunim me organet drejtuese te Federates ne nivel qendror. Kjo pune eshte duke vazhduar edhe ne Kruje e Lushnje, me synim riorganizimin e seksioneve sindikale te ketyre rretheve brenda muajit dhjetor, nderkohe qe punohet paralelisht edhe me rrethet Malesi e Madhe e Peqin.

Permiresimi i punes me seksionet u pa i lidhur ngushte me rritjen e te ardhurave te Federates, nepermjet zbatimit te detyres statutore te grumbullimit te koutave te anetaresise, si parakusht per funksionimin normal te saj dhe organizimin e aktiviteteve sindikale, sidomos per trajnimin e drejtuesve lokale dhe zbatimin e Kontrates Kolektive te Punes.

Ne mbledhje u evidentua puna e mire e disa seksioneve, si ai i Vlores, Tiranes Qytet, Skraparit, Tepelenes, Mallakastres, Kucoves, Bulqizes, Permetit, Librazhdit, Dibres dhe njekohesisht u terhoq vemendja per disa seksione si ai i Matit, Gjirokastres, Korces, Kukesit, Shkodres etj, ndaj te cileve u kerkua qe te angazhohen konkretisht drejtuesit e tyre, ne bashkepunim me aktivin e rretheve perkatese, per te saktesuar anetaresine me listat perkatese dhe per te plotesuar e dorezuar ne Drejtorite Arsimore dokumentacionin e plote, sipas Kontrates Kolektive te Punes. Ne lidhje me kete ceshtje, u nenvizua puna e mire qe kane bere kryesite e te dyja sindikatave, te cilat kane organizuar takime e konsulta, jo vetem ne nivel qendror me perfaqesues te Ministrise se Arsimit e Shkences, por kjo gje eshte shtrire edhe ne Drejtorite dhe Zyrat Arsimore te shumices se rretheve, ku, krahas problemeve te partneritet dhe bashkepunimit efektiv per ceshtjet qe lidhen me kerkesat per nje arsim cilesor per te gjithe, per shmangien e largimeve nga shkolla dhe eliminimin e punes se femijeve, jane diskutuar dhe eshte rene dakord edhe per procedurat e mbledhjes se kuotizacionit. Ne keto kushte, u theksua pergjegjesia e drejtperdrejte e kryetareve te seksioneve per mbarevajtjen e kesaj pune, duke evidentuar anetarsine me lista te rregullta sipas kerkesave dhe rregullave te percaktuara.

Vijon në faqen 8

Vijon nga faqja 7

Ne vijim, Zoti Xhafer Dobrushi informoi Keshillin per masat konkrete qe eshte duke marre Kryesia e Federates per plotesimin e disa kerkesave te anetareve dhe per zbatimin e disa neneve te Kontrates Kolektive qe lidhen me perdorimin me me efektiviet te Fondit te Vecante, duke synuar motivimin e mesuesve te dalluar ne mesimdhenie dhe ne aktivitetet sindikale, pagesen nga ana e punedhenesit te shpenzimeve per viziten e detyruar per Librezen Shendetesore, si kerkese e detyrueshme vjetore per cdo mesues qe eshte i anetaresuar ne sindikate si edhe per zbatimin e rregullave e kritereve per emerimin dhe levizjen e mesuesve, sidomos te atyre me shkolle te mesme pedagogjike etj, duke shmangur veprimet e njeaneshme e arbitrare, si edhe per hartimin dhe miratimin e Kodit te Etikes per Mesuesit.

Drejtuesit e seksioneve qe e moren fjalen per diskutim: Isa Reka, Shkelqim Polloveshi, Petref Celaj, Dilaver Dika, Zela Koka, Filip Rajta, Muhamet Vatoci, Selami Kaza, Skender Skenderi, Hysen Goci, Bashkim Shyle, Muharrem Shqarri, Enver Hora, Saliko Hodo e te tjere, informuan per punen e bere dhe situaten ne rrethet perkatese dhe ngriten probleme te ndryshme qe kane te bejne me kerkesat e mesuesve anetare te FSASH-it, sidomos per disa nene te Kontrates Kolektive te Punes qe nuk po gjejne zbatim e sidomos per pagesen e dy pagave per mesuesit qe dalin ne pension, per veprimet e njeaneshme ne levizjen e disa mesuesve, per motivimin me te mire te mesuesve qe kane rezultate te mira dhe qe jane te aktivizuar ne pune dhe aktivitete jasht procesit mesimor etj.

Pas sqarimit te angazhimeve te Kryesise se Federates per trajtimin dhe venien ne rrugen e zgjidhjes te ketyre problemeve e kerkesave, zoti Xhafer Dobrushi, trajtoi problemin e zgjedhjeve te reja per organet e te gjitha niveleve te FSASH, perfshire edhe Kongresin e Federates. Pas diskutimeve, Keshilli Drejtues i FSASH pranoi propozimin e Kryesise, sipas te cilit programi i fushates se zgjedhjeve, perfshire objektivat dhe fazat konkrete te kesaj fushate do te diskutohen dhe miratohen ne mbledhjen e analizes vjetore te FSASH ne fillim te muajit shkurt 2009.

Zedhenesi i FSASH

Te forcojme strukturat sindikale te SPASH ne te gjitha nivelet

Nga mbledhja e Keshllit Kombetar te SPASH

Ne mbledhjen e radhes te Keshllit Kombetar te SPASH, qe u zhvillua para disa diteve ne Durres, u analizua veprimtaria e SPASH-it gjate vitit 2008, gjendja organizative dhe ajo financiare.

Fjalen e hapjes e mbajti kryetari i SPASH-it z.Bajram Kruja, i cili paraqiti dhe rendin e dites, ndersa Raportin e mbajti Zv, Kryatri, z.D.Spahiu.

Nder te tjera ne raport u theksua:

Sot me kenaqesi deklarojme se SPASH ka realizuar me sukses veprimtarine e saj te aprovuar nga Keshili kombetar. Ne mbledhjen e pare zhvilluar ne muajin shkurt me teme: "Kontrata Kolektive dhe sherbimet per antaret e drejtuesit sindikaliste" qe u referua nga z.Bajram Kruja, u bene shume pyetje dhe diskutime. Me keqardhje duhet te pranojme se, akom, jo vetem disa antare, por edhe disa drejtues ne shkolla, jane te paqarte dhe shtrojne pyetjen "Cfare na ka thene sindikata?", "Pse duhet te jemi antare?"etj.

Eshte e vertete se kjo eshte nje krize shqetesuese edhe ne disa sindikata moderne ne shtete shume te zhvilluar ekonomikisht, por duhet te theksojme se Neni 13/4 mbi reduktimin e oreve te mesimit per drejtuesit sindikaliste, Neni 13/10 mbi klasat kujdestari, Neni 13/12 mbi pagesen e 4 mbledhjeve te Keshillit Kombetar nga DAR-ZA, Neni 7/7 mbi pjesmarrjen ne aktivitete sindikale, si edhe nene te tjere, te cilet tregojne disa nga sherbimet qe ne u ofrojme antareve e drejtuesve te sindikates.

SPASH dhe FSASH jane duke u marre konkretisht me kete ceshtje dhe per kete problem, edhe me mbeshtetjen e Projektit qe jemi duke zbatuar me sindikatat holandeze FNV/AOb, kane zhvilluar edhe nje Tryeze te Rrumbullakte dhe kane paraqitur nje projekt ide e cila eshte botuar edhe ne Revisten "Tribuna Sindikale" ne muajin prill te ketij viti.

Ne mbledhjen e Keshillit Kombetar te qeshorit me teme:"Roli i gruas ne arsim dhe sindikate", ku referoi zj.Bukuroshe Shabani, u theksua rendesia e rolit te gruas ne arsim dhe sindikate, por edhe ne seminare e aktivitete te tjera, sic eshte seminari i zhvilluar ne fund te marsit ku moren pjese eksperte sindikaliste te sindikates holandeze AOb. Ne konkluzionet e ketij seminari, te cilat jane botuar edhe ne Revisten "Tribuna Sindikale ne muajin maj, u pergezuan grupet e punes dhe u pershendeten drejtuesit e ketij seminari si zj.Bukuroshe Shabani e zj.Albina Pepo, te cilat kane punuar me nje numer te konsiderueshem mesuesesh qe u perzgjodhen dhe u organizuan ne 13 grupe pune, duke bere mbi 65 anketime, ne kuadrin e zhvillimit te ketij seminari dhe ne zbatim te Projektit FNV/AOb.

Ne mbledhjen e muajit shator me


teme:"Statuti, organet drejtuese, funksionimi dhe vendimi", ku referoi z.Bajram Kruja u saktesuan ndryshimet ne Statut, organet drejtuese dhe funksionimi i tyre. Ne vijim u organizua aktiviteti i perbashket me tre sindikatat e arsimit, SBASHK, SPASH, FSASH, nje takim vllazeror dhe i paharruar per sindikalistet kosovare dhe shqiptare. Aktiviteti eshte pasqyruar shume mire nga z.Aleks Dushi ne Revisten "Tribuna Sindikale" ne muajin shtator.

Por pjesmarrja e drejtueseve te seksioneve ne mbledhjet e Kshillit Kombetar nuk ka qene e plote.Terheqim vemendjen e drejtueseve te rretheve Gjirokaster, Peqin, M.Madhe.

Strategjia e SPASH-it gjate vitit 2008 ka qene partneriteti dhe demokracia ne arsim. Me 27 mars u zhvillua konferenca trepaleshe "Mbi zbatimin e legjislacionit te punes ne arsim", ku moren pjese Zv.Ministri i Punes, zoti Kastriot Sulka dhe Zv.Ministri i Arsimit z. Halit Shamata, si edhe 12 drejtoret e qarqeve, DAR, dhe kryetaret e sindikatave te qarqeve. Ne kete Tryeze u be nje analize reale mbi zbatueshmerine e legjislacionit te punes, si dhe te partneritetit social ne te gjitha nivelet, mbi permirsimin e pages, kushteve te punes, shperblimeve, kritereve te punesimit si dhe lirite sindikale dhe u vendose qe takime te tilla te behen me kokrete ne te gjitha rrethet e vendit. Ne zbatim te kesaj detyre, jane realizuar takime me DAR-ZA si ne Tirane qytet dhe qark, Shkoder, Elbasan, Korce, Fier, Durres, Lushnje, Kucove, Lezhe, te cila jane pasqyruar edhe ne Revisten "Tribuna Sindikale"

Po keshtu, nga vezhgimet e bera dhe nga takimet e zhvilluara verejme se jo ne te gjitha rrethet funskionoine strukturat e SPASH-it si partner social.

Duhet te thekesojme, gjithashtu, se autoriteti i dy sindikatave tona te arsimit, si edhe ndikimi i drejtuesve te dy sindikatave tane beri qe, per here te pare, Keshillit Kombetar i Punes, trajtoje si teme te vecante problemet e partneriteti dhe nevojave te arsimit, ku pati vleresime dhe konkluzione te rendesishme per punen tone.



Nder veprimtarite mjat te rendesishme te SPASH-it ka qene dhe eshte edhe angazhimi per eliminimin e punes se femijeve, mbeshtetur edhe nga Projekti me FNV/AOb, qe perfshin edhe nje Tryeze mbi kordinimin e veprimtarive per eliminimin e punes se femijeve, zhvilluar ne Tirane, me date 25-26 prill, ku moren pjese me shume se 50 perfaqesues nga dy sindikatat qendrore BSPSH-KSSH, si edhe dy ministrat, i Punes dhe i Arsimit, ku u paraqiten prezantimet mbi punen e sindikatave te arsimit per uljen e braktisjes se shkolles dhe nevojen e angazhimit edhe te sindikatave te degeve te tjera per eliminimin e punes se femijeve.

Ne kete kuader, u realizua edhe marveshja me sindikatat e ndertimit, kimise, tekstileve, bujqesise etj, te mbeshtetura keto edhe nga Inspektoriati i Punes prane Ministrise se Punes, Drejtoria e Politikave te Punesimit dhe ILO-IPEC.

Ne kete marrveshje bashkpunimi iu be thirrje edhe sindikatave europiane, per te mbeshtetur sindikatat shqiptare ne punen qe ato jane duke bere. Rezultatet, ne zbatim te ketyre detyrave kane qene positive e inkurajuese dhe ne kemi marre pergezime edhe nga sindikatat holandeze FNV-AOb.

Detyre e rendesishme per SPASH ka qene rritjen e numrit te antareve te saj si edhe mbledhja e kuotave. Ka rrethe qe kane punuar mire, dhe per kete, ne emer te Keshillit Kombetar pershendesim z.A. Doraci, rrethi Durres, z.A. Kola, rrethi Mat, z.P. Prenga, rrethi Puke, zj.A. Pepo, rrethi Korce, z. L. Zonja, rrethi Lushnje, si edhe H.Meculi Tirane, per punen e bere.

E gjithe kjo verprimtari e realizuar me sukses duhet te na inkurajoje dhe te na vleje qe me kete rritem te punohet edhe per periudhen e mbetur te ketij viti dhe per vitin e arrdhshem, mbasi do te jete viti i zgjedhjeve, si ato neper sindikatat ne shkolla, ne seksionet e rretheve e deri tek zhvillimi me sukses i Kongresit te SPASH-it.

Deferim SPAHIU
Zv.Kryetar i SPASH

U nda nga jeta Zv/Kryetari i FSASH, Berti Çaprazi



Pak dite me pare, pas nje semundjeje te rende, u nda nga jeta Zv/ Kryetari i FSASH-it, mesuesi i dalluar, kolegu dhe miku yne dhe i shume mesuesve e nxenesve te Shkolles se Kasharit, te rrethit te Tiranes e me gjere, Berti Çaprazi.

Mesuesia ishte profesioni dhe pasioni i jetes se Bertit. Pas mbarimit te shkolles 8-vjecare e te mesme ne Korce dhe pas diplomimit ne shkollen e larte ne Elbasan, ai punoi per me shume se 38 vjete me radhe si mesues, ne fillim ne Librazhd, e me vone, deri ne fund te jetes, ne Tirane.

Berti karakterizohej nga cilesite me te mira te nje edukatori progresiv, si aftesia profesionale, korrektesa, urtesia, toleranca, shpirti i sakrifices dhe kembengulja per te permbushur me se miri cdo detyre qe merrte persiper.

Perkushtimi per detyren, natyra e tij humane dhe gatishmeria per t'u sherbyer te tjereve, e kishin bere Bertin perfaqesues te nje numri te madh mesuesish e kolegesh, te cilet ai u perpoq t'i perfaqesonte e t'i mbronte, duke qene ne krye te sindikates, jo vetem ne shkolle e ne shkalle rrethi, por edhe me gjere ne nivel kombetar, si kryetar i Seksionit Sindikal te Rrethit te Tiranes dhe Zv/ Kryetar i Federates se Arsimit e Shkences, per shume vite, deri ne fund te jetes se tij.

Berti, gjithashtu, ishte nje aktivist i dalluar dhe perfaqesues i denje i komunitetit ku banonte. Ai u zgjodh, me voten e popullit te Kombinatit, anetar i Keshillit te Njesise Bashkiake, ndersa Keshilli Bashkiak i kesaj Njesie e zgjodhi kryetar te tij, detyre te cilen e mbajti deri ne ditet e fundit te jetes.

Mesuesit e Kasharit e te Tiranes, ne perfaqesuesit e Federates ne te gjitha nivelet, humbem kolegun, mikun dhe njeriun e mire, mesuesin e afte dhe dashamiresin e mbrojtesin e vendosur sindikal, por ne kemi shembullin e Bertit, i cili do te na sherbeje kurdohere ne punen tone per zhvillimin e arsimit dhe mbrojtejn e interesave social ekonomike te mesuesve dhe punonjesve te tjere te sistemit te arsimit.

Duke i shprehur edhe njehere ngushellimet tona te sinqerta e te thella familjes se Bertit, bashkeshortes e femijeve, ne bashkojme forcat per kapercimin e kesaj dhimbjeje dhe per realizimin e idealeve qe edhe Berti kishte per zhvillimin e arsimit dhe perparimin e mesuesve ne vendin tone.

Kryesia e FSASH

PREZANTOHET DRAFTI PERFUNDIMTAR I KODIT TE ETIKES SE MESUESIT

Grupi i Punes qe ka punuar per hartimin e draftit te Kodit te Etikes se Mesuesit me mbeshtetjen e Fondacionit Soros organizoi keto dite disa veprimtari per preantimin e draftit perfundimtar, me synimin per ta bere ate te njohur ne nje mase sa me te gjere te mesuesve, sindikalisteve, drejtuesve te arsimit, prinderve dhe aktoreve te tjere te interesuar, para se drafti t'i dorezohet Ministrit te Arsimit dhe Shkences.

Ne kete kuader, nje veprimtari e tille u zhvillua me shoqatat dhe Konfederaten e Prinderve si dhe me drejtoret e Drejtorive Rajonale dhe Zyrave Arsimore ne rrethe.

Ne keto takime autoret e draftit Tomi Treska, Zenel Sina, Xhafer Dobrushi, Bajram Kruja, Albana Markja dhe Mirela Berisha prezantuan para pjesemarresve permbajtjen e pjeseve te vecanta te Kodit te Etikes se Mesuesit.

Me interes te vecante ishte veprimtaria qe u zhvillua ne qytetin e Durresit me pjesemarrjen e kryetareve te Seksioneve Sindikale te FSASH e SPASH ne rrethe. Rreth 65 pjesemarres, drejtues vendor te sindikatave te arsimit, mbasi degjuan prezantimin nga autoret e Kodit shprehen vlersimin e tyre per punen e bere dhe theksuan se shkollat, sindikatat dhe mesuesit e presin me interes miratimin e ketij drafti dhe hyrjen e tij ne veprim si nje mjet qe do te ndikoje ne vleresimin me te mire te punes dhe te figures se mesuesit, ne forcimin e metejshem te marredhenieve mesues- nxenes, mesues drejtues dhe anasjelltas dhe ne marredheniet e mesuesve me prinderit e komunitetin.

Nje aspekt i rendesishem per zbatimin e ketij Kodi eshte Mekanizmi Rregullator i tij, draftin e te cilit po e botojme ne vijim.

MEKANIZMI RREGULLATOR I KODIT TE ETIKES SE MESUESIT

Grupi i punes qe punoi per hartimin e draftit te Kodit te Etikes se Mesuesit u kujdes dhe diskutoi shume per percaktimin e mekanizmit qe rregullon zbatimin e ketij Kodi .Si zgjidhje grupi propozoi nje shtese ne Ligjin ekzistues te arsimit parauniversitar, ku te perfshihej nje norme juridike ne formen e nje neni me disa pika, qe t'i pergjigjen kesaj permbajtjeje.

Ne baze te ketyre kritereve u pergatit drafti qe vijon:

1. Per t'u punësuar si mësues në të gjithë sistemin e arsimit parauniversitar dhe për ta pasur këtë titull gjatë gjithë karrierës, *kandidati*, përveç kërkesave dhe standardeve që duhet të plotësojë sipas kuadrit ligjor të marrëdhënieve të punës të përcaktuar në Kodin e Punës dhe në Kontratën Kolektive të Punës, *duhet të plotësojë edhe kriteret që përmban Kodi i Etikës së Mësuesit.*

- Kodi i Etikës së Mësuesit është një tërësi normash dhe rregullash sjelljeje, që mësuesit dhe drejtuesit e çdo rangu në nivel shkolle janë të detyruar t'u përmbahen në veprimtarinë e tyre në shkollë dhe jashtë saj, në marrëdhënie me nxënësit, me eprorët apo me vartësit, me kolegët, me prindërit dhe me gjithë komunitetin në shkollë, përfshirë edhe rregullat e sjelljes dhe mënyrën e paraqitjes në shkollë dhe në komunitetin ku jeton.

- Kodi i Etikës së Mësuesit *hartohet nga MASH në bashkëpunim* me partnerët socialë dhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile, të interesuar dhe të angazhuar në procesin e zhvillimit dhe të modernizimit të arsimit në vendin tonë dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave.

- Organet, që garantojnë zbatimin e Kodit të Etikës së Mësuesit, janë *Këshilli i Etikës, në nivel kombëtar, dhe Komisionet e Etikës, në nivel vendor*. Përbërja, kompetencat dhe mënyra e funksionimit të Këshillit/ Komisioneve të Etikës së Mësuesit përcaktohen *me VKM.*

2. Parime të përgjithshme:

- Këshilli/Komisionet i/e Etikës së Mësuesit janë organet që garantojnë zbatimin e kërkesave dhe të rregullave të Kodit të Etikës së Mësuesit.

KKEM është i pavarur nga MASH dhe nga organizma të tjerë shtetërorë qendrorë ose vendorë.

- Këshilli i Etikës së Mësuesit funksionon në nivel qendror, ndërsa komisionet në nivel vendor, në shkallë prefekture dhe n/prefekture.

- Këshilli i Etikës së Mësuesit, me rregullore të veçantë, të miratuar prej tij, përcakton marrëdhëniet me Komisionet vendore dhe kompetencat e tyre.

3. Rreth përbërjes së këtij organizmi:

Këshilli i EM përbëhet:

- Nga 2 përfaqësues të emëruar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës, nga radhët e personaliteteve më përfaqësuese që punojnë në sistemin e arsimit para-universitar.

- Nga 2 përfaqësues të zgjedhur nga sindikatat nënshkruese të KK të Punës të nivelit të parë.

- 1 përfaqësues nga pushteti vendor, i zgjedhur nga Shoqatat e Bashkive dhe Komunave të vendit.

- 1 përfaqësues nga komuniteti i prindërve,

- 1 përfaqësues nga komuniteti i nxënësve.

Mandati i Këshillit të Etikës së Mësuesit është 4 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje ose riemërimi vetëm një herë.

- Komisionet e EM funksionojnë në bazë të Statutit dhe të Rregullores së Këshillit të EM.

- Këshilli i EM, në mbledhjen e tij të parë, zgjedh një kryetar dhe një n/ kryetar.

- Këshilli i EM, në një nga mbledhjet e tij të para, miraton Statutin dhe Rregulloren e tij.

4. Komisionet e EM në nivel vendor përbëhen:

- Nga 2 përfaqësues të emëruar nga Drejtori i DAR/ZA nga radhët e mësuesve më të dalluar të Prefektures/nenprefektures.

- Nga 2 përfaqësues të zgjedhur nga seksionet sindikale

- Nga 1 përfaqësues i zgjedhur nga Bashkia ose Komuna, ku është i punësuar mësuesi ose drejtuesi i shkollës që gjykohet

- Nga 1 përfaqësues i komunitetit të prindërve nga shkolla ku është i punësuar mësuesi ose drejtuesi që gjykohet në komision

- Nga 1 përfaqësues i komunitetit të nxënësve nga shkolla ku është i punësuar mësuesi ose drejtuesi që gjykohet në komision

Anëtarët e Komisionit të EM emërohen dhe zgjidhen nga punëdhënësi dhe nga sindikatat për një mandat 4-vjeçar, me të drejtë riemërimi ose rizgjedhjeje vetëm një herë.

Anëtarët e Komisionit të EM nga pushteti vendor, komuniteti i prindërve dhe nxënësve zgjidhen nga Bashkitë, Komunat ose komunitetet e shkollave, ku është i punësuar mësuesi ose drejtuesi

5. Kompetencat e KKEM

- Komisioni Vendor i Kodit të Etikës së Mësuesit shqyrton rastet konkrete të përputhjes së sjelljes së mësuesit apo të drejtuesit, në shkollë dhe jashtë saj, me kërkesat e Kodit të Etikës së Mësuesit dhe merr vendimet përkatëse.



- Vendimet e Komisionit Vendor të KEM shqyrtohen dhe vlerësohen, në çdo rast, nga Këshilli i EM, vendimet e të cilit janë të formës së prerë dhe të paapelueshme në organet e administratës shtetërore.

- Vendimet e Këshillit/Komisionit Vendor merren me 2/3 e anëtarëve të tij.

6. Rreth misionit

- Mbrojtja e nxënësve nga praktikat negative

- Mbrojtja e figurës së mësuesit

- Mbrojtja e figurës së drejtorit të shkollës

7. Rreth funksioneve:

- Merr informacion rreth shkeljeve të kryera dhe ankesave të adresuara

- Shqyrton dhe verifikon rastet e këtyre shkeljeve/ankesave nëpërmjet ngritjes së komiteteve ad-hoc

8. Merr masa ndaj mësuesve/ drejtuesve, kur vërtetohen shkelje, të tilla, si: - Vërejtje me gojë

- Vërejtje me shkrim

-Vërejtje me paralajmërim për pezullim nga puna

-Transferim në një nivel më të ulët të sistemit të arsimit

- Ulje në kategori, heqje për një kohë të caktuar të së drejtës së titullit të mësuesit.

- Heqje përgjithmonë të titullit të mësuesit.

- Gjoba

9. Dokumentet bazë të këtij organizmi janë:

- Statuti

- Rregullore e brendshme e funksionimit organizativ

- Rregullore e brendshme e funksionimit financiar

10. Organet përbërëse të këtij organizmi janë:

- Bordi drejtues

- Sekretari

- Komitete ad-hoc

11. Funksionimi

Këshilli i EM ka selinë në Tiranë, në një mjedis që cakton ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Në shërbim të Këshillit, ministri i Arsimit dhe Shkencës emëron dhe paguan një sekretar, i cili përgjigjet përpara Këshillit dhe kryetarit të tij, administron dokumentacionin, përgatit dokumentacionin dhe mban lidhjet me Komisionet e EM.

Për funksionimin e Këshillit dhe të Komisioneve të EM, MASH brenda buxhetit të saj, cakton çdo vit një fond të posaçëm.

Organizmi mblidhet sipas kërkesave që i drejtohen atij, por në çdo rast, jo më pak se 2 herë në vit.